

VENDIM
Nr. 381, datë 13.5.2020

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE TEK AGJENCIA SHETETËRORE E KADASTRËS, TË MJEDISEVE TË ARKIVIT SHETETËROR VENDOR TË QARKUT TIRANË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, 13, 14 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 6 e 7, të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Zëvendëkryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të mjediseve të Arkivit Shtetëror Vendor të Qarkut Tiranë, të ndodhura në zonën kadastrale 8 330, me numër pasurie 8/114, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar.


3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Mjediset e Arkivit Shtetëror Vendor të Qarkut Tiranë

PLANIMETRIA E KATIT TË TRETË NE KUOTEN +15.13



		Mbledhjet e Arkivit Shtetëror Vendor Tiranë	
Titulli i Projektit:		PLANIMETRIA E KATIT TË TRETË	
Niveli:		+15.13	
Sipërfaqja:		1132 m ²	
Skala:		1 : 100	
Data:		10.01.2020	
Disiplinë:		Arkivim	
Autorizim:		[Signature]	